

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME SEVIME GJINALIN

Prishtinë | Data: 20 janar, 2017

Kohëzgjatja: 63 minuta

Të pranishëm:

- Sevime Gjinali (E intervistuar)
- Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
- Petrit Çeku (Intervistuesi)
- Donjeta Berisha (Kamera)
- Venera Mehmetagaj Kajtazi (E bija e Sevimes)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Erëmirë Krasniqi: A mundeni...

Petrit Çeku: Tash, po?

Erëmirë Krasniqi:... emrin dhe mbiemrin? A mundeni me fol për kujtimet e juja ma t'hershme t'fëminisë, familjen edhe rrethin ku jeni rritë?

Sevime Gjinali: Une jam Sevime Kabashi, Gjinali tash, e martuar. Kam lindë në Prizren me 1937 nga ni familje e arsimume. Nana ka ditë shkrim-lexim, baba poashtu. Edhe fëmininë e kam bo deri në vitin 1954 në Prizren. Mandej kam vazhdu studimet në Beograd.

Erëmirë Krasniqi: Çka ju kujtohet prej asaj kohës, prej fëminisë? A keni...

Sevime Gjinali: Si fmi, si fmi kështu e ledhatume, masi kam qenë ma e vogla kam qenë pak jo e qetë. Vazhdimisht kam bo probleme, kam qenë e gjallë. E kam pasë qef muzikën, se edhe familja ime, baba përndryshe, thonë se ka shkru kangë edhe ka pasë ni za shumë t'bukur... për shoqni ka qenë shumë i dashtun. Edhe në moshën pesë vjeçare m'kanë regjistru në shkollën fillore. Si pesë vjeçare kam ditë shkrim-lexim, edhe në klasën e parë në shkollën "Bajram Curri", në Prizren. Në atë shkollë kanë qenë disa paralele me mësus të ndryshëm. Njeri prej tyne ka qenë Nuri Sherifi i cili ka lujtë në piano edhe në klasë e ka pasë ni pianino.

Unë kom qenë te ni msus tjetër, ai ka qenë i Shqipërisë, po kur e mora vesh se ai msusi, Nuri Sherifi, lunë në mandolinë edhe në piano, kam ikë prej klasës te ai. Edhe kërkush s'e ka ditë këte. Unë nuk e di si e kam shprehë atë, kam qenë e lirë, kam mendu se muj edhe ashtu me vepru. Ai, msusi im e kishte

thirrë babën, ka thonë, “Qekshtu, qekshtu vajza ka bo, une du me ju njoftu”. [Baba] “Shumë mirë paska bo ajo, shumë me mend paska bo”.

Edhe aty, nxanse shumë e mirë, kam ditë me këndu, e shkëlqyshme. I kam pasë disa shokë që kanë qenë vazhdimisht kështu të shkëlqyshëm, bojshim gara. Edhe mas shkollës fillore, si zakonisht, atje ka qenë shkolla e gjimnazit me tri vite, gjysëm-matura. Une kalova n’gjimnaz, po...

Erëmirë Krasniqi: Deshta me ju pytë kur keni shku n’shollë, a ka qenë periudha juj në Shqipëri, ‘43? N’cilin vit ke qenë... kur keni fillu?

Sevime Gjinali: Jo, prej ‘37, ‘38.... Në ‘41-shin, ‘41-shin koha e pas luftës. Po, ni kohë tepër e vështirë. Nuk ka qenë kohë e, nën sundimin e...

Erëmirë Krasniqi: A, s’ka qenë kjo periudhë nën sundimin e Serbisë... ok...

Sevime Gjinali: Po.

Erëmirë Krasniqi: E përmendet që ka pasë profesor të Shqipërisë?

Sevime Gjinali: Po, jo, ai ka jetu në Prizren, po prejardhjen nga Shqipëria ka qenë. Përndryshe, msusët në atë kohë kanë ditë me lujt në ni instrument, ashtu ka qenë. Kanë qenë ni asi... ni kulturë t’gjanë e kanë pasë. Në shkollimin tim në gjimnaz, u hap shkolla e muzikës e ulët në Prizren. Unë në atë kohë, masi isha me familje që kanë qenë artdashës, u regjistrova në shkollën e ulët të muzikës në Prizren. Dhe menjëherë mas gjysëm-maturës u regjistrova në klasën e parë të shkollës së mesme.

Aty u dallova për talent dhe në atë kohë shkollimi ka qenë me disa arsimtarë që kanë qenë arsimtarë të pakualifikum. Lorenc Antoni ka qenë edhe drejtor edhe msimdhanës. Kështu që, Lorenc Antoni bashkë me ne i ka mësu edhe landët e muzikës. Në mbikqyrejn e profesorëve nga Beogradi, ata vishin vazhdimisht bojshin kontrolla dhe vlerësojshin dijeninë tonë edhe jepshin këshilla se si me vepru. U dallova si e dallume aty. Mu m’zgedhën, m’thanë, “Ti ke me ardhë, me shku në Beograd me studju”.

Në vitin 1954 u regjistrova në Beograd në Akademinë e Muzikës të asaj kohe. Me propozimin po t’profesorit tim të solfexhos që t’i vazhdoj atje studimet, po une masi u dallova në instrumentin e pianos, e regjistrova edhe pianon nën B edhe seksionin e pedagogjisë.

Erëmirë Krasniqi: A t’kthehemi te familja jote zonja Sevime?

Sevime Gjinali: Po.

Erëmirë Krasniqi: Ju e përmendët që motrën e keni pasë...

Sevime Gjinali: Po, po. Familja ime... familja ime ka qenë ni familje e njoftun patriote. Kabashët, ata janë të njoftun edhe për patriotizëm. Ka edhe folklor, ka kangë që thurren për trimnin e tyne. Vazhdimisht kanë luftu në ni mënyrë për, për të drejtat e shqiptarëve. Baba im ate s'e ka tregu ndaj fëmijve, po mendoj ajo edukatë ka qenë si e trashëgume, po edhe situata me siguri e ka bo t'vetën. Vëllau im ma i madhi, Ruzhdi Kabashi, ka qenë, ka pasë afinitet për, për radio, për teknikën e radios. E në atë kohë, ka qenë ni kohë tepër e vshtirë, nuk lejojshin që t'bohët ai... si, si vet prej afinitetit ka pasë bo ni radio stacion t'vetin në Prizren. Ajo kohë e vështirë dikush, dikush ka përgju edhe ka shku ka tregu. Ka thanë se, "Ruzhdiu po bon radio stacione", dhe ajo si armiqësore osht' trajtu edhe e kanë marrë vëllaun në burg. Si i burgosun osht' majtë dy muj në qeli... qeli, edhe ka fjetë n'beton. Kështu që, e ka marrë t'kallnit e mushknive, mandej prej tuberkullozit ka vdekë.

Ajo tragjedi... mandej motra ime ma e madhja, edhe ajo e ndikuar prej, prej mospasjes të lirisë të shqiptarve, është lidhë me Ballin Kombëtar. Aktiviste e Ballit Kombëtar, përndryshe ka punu në gjygin e Prizrenit... gjygin e Prizrenit. Shumë punëtore e dalluar. I ka shtypë krejt materialet për atë parti, prej asaj kanë rrjedhë mandej.... Disa të tjerë po ashtu n'atë, n'atë parti kanë qenë.... Ne s'kemi ditë si fëmi. Edhe meniherë mas veprimtarisë saj shpejtë edhe ajo u burgos. Prej serbëve përndryshe, edhe u dënu me tetë vjet burgim. Gjashtë vjet burg i boni e dy me kusht ka qenë.

Kështu që, familja jonë vazhdimisht e ka pasë, që thojnë, posteqinë n'burg (të gjithë qeshin). Ajo ndjenjë e vujtjeve tona, prej vëllaut, prej motrës, na ka bo që t'jemi shumë t'kujdesshëm edhe n'shoqni edhe ni lloj kompleksi familjar se shumë vshtirë kemi me i përjetu këto gjana. Edhe rrethi gjithmonë na ka trajtu disi si, si armiqësor. Po, kemi qenë shumë familje n'za kështu për nga edukata, të gjithë të shkollum, me motra, me të gjithë.

Në atë kohë s'ka pasë mësuse. Motrat e mija kanë qenë mësuset e para. Nedimja, si mësuse e parë në shkollën fillore në Prizren, përndryshe i ka mësu edhe... ka pasë kurse analfabetike në atë kohë i ka mësu femnat. Si 13 vjeçare, në atë kohë bojshin transferime ku dojshin, ate e kanë çu jo në Zhur, andej-knej ka punu. Edhe ajo osht' marrë me muzikë, ka qenë në shoqinë amatore "Agimi" përndryshe.

Erëmirë Krasniqi: Kjo ka qenë msimi në gjuhën shqipe në atë kohë? A pati fillu...

Sevime Gjinali: Shkollimi, shkollimi në gjuhën shqipe ka qenë, po nën sundimin, dihet, okupatorit.

Në...

Erëmirë Krasniqi: Ju përmendët që edhe baba juaj ka bo komponime. A mundesh me na tregu diçka...

Sevime Gjinali: Baba im...

Erëmirë Krasniqi: A mundesh me na tregu çfare?

Sevime Gjinali: Baba im.... Po shifni, në atë kohë nuk ka pasë shkrime, regjistrime të muzikës, as fletore me pentagram me nota. Ai ka qenë vetë rapsod, vetë meniherë tekstin edhe muzikën e ka bo. Po ato s'i ka shënu kërkush, s'ka pasë mundësi atëhere m'u inçizu.

Erëmirë Krasniqi: A jonë përcjellë prej gjeneratës?

Sevime Gjinali: Prej gjenerate... po qajo përcjellja domethanë, na si edukatë e kemi marrë familjare ate. Dhe ai ka vendosë për këtë shkollimin tim, që une t'bahem muzicente, t'shkoj n'muzikë... se në atë kohë nuk ka pasë, ka qenë dishka jo e zakonshme që t'shkon femna n'shollën e muzikës me violinë. Na gjujshin fëmitë në rrugë më gurë kur t'na shifshin, se me violinë po shkoj në shkollë t'muzikës.... Si femën ka qenë pak jo e zakonshme.

Erëmirë Krasniqi: A ka pasë femna tjera?

Sevime Gjinali: Ka pasë femna tjera, ka pasë edhe femna t'talentume. Përndryshe, Prizreni oshtë i njoftun si qytet i talenteve, jo vetëm për muzikë, po për dramë, e për pikturë, e... s'ka nevojë t'i përmendi une të gjithë ata që kanë dalë prej Prizrenit. Edhe Prizreni tash e ka dëshmu veten se oshtë me t'vërtetë ni qytet i artit.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë aktivitete kulturore publike keni pasë në atë kohë?

Sevime Gjinali: Eh, në atë kohë organizoheshin koncertet e Shoqërisë "Agimi". Koncertet e shkollës muzikës, si nxanse kom marrë pjesë në koncertet e shkollës. Lujsha në piano edhe n'violinë edhe kemi pasë formu ni orkestër t'vogël të nxansve, edhe aty bojshim muzikë. Përndryshe, inçizimet e para të Radio Prishtinës kanë qenë me motrën time, duet unë edhe motra, i kemi inçizu kangët popullore në Radio Prishtina.

Erëmirë Krasniqi: Nëse mundeni me përmend emra, edhe kur thuni motra përmendjani edhe emrin që ta kemi si referencë?

Sevime Gjinali: Nedime Kabashi, si mësuese e parë edhe aktive në Shoqërinë Amatore “Agimi”.

Erëmirë Krasniqi: Qysh shkut ju në Beograd? A kishit mujt me na tregu këtë pjesë?

Sevime Gjinali: Beogradi... destinacioni ka qenë shumë me randësi për mu. E re, 14 vjeçare, u regjistrua në Akademi. Të gjitha ato dëshirat e mija nuk mundën m’u plotësu, se une kisha dëshirë pianon si instrument kryesor, mirëpo nuk kishte kushte se une ka qenë dashtë ta kem pianon n’banesë ose n’shpi. Une banojsha në, në internatin e studentëve, aty s’kishte. Fillova me bo pagesë te ni zojë, privat, në shpi private me ushtru, po s’mujta me ia dalë, s’kisha mjete financiare.

Në atë kohë edhe motrën e kisha në burg në Pozharevc. Isha e detyrume me, me nda prej gojës, me e shitë tiketën e ushqimit, t’drekës ose darkës, me udhëtu, me shku me e vizitu motrën. Kushtet kanë qenë ma, shumë t’vshtira, kështu që u detyrova pianon mos me e pasë landë kryesore po nën B e kisha.

Erëmirë Krasniqi: E çka ishte kryesorja?

Sevime Gjinali: Kryesorja seksioni arsimor i pedagogjisë, landë pedagogjike ishin kryesore. Mirëpo, isha shumë e dalluar për nga landët, sidomos landa kryesore solfexho, harmoni.... Kështu që, kam diplomu më komponimin e ni forme tokata i thojnë asaj, fuga, invencione, ato që i kanë shkru kompozitorë t’vjetër... të Bachut... me nota t’shkëlqyshme. Aty diplomova në afatin rekord për katër vjet edhe meniherë u ktheva në Prizren që ta vazhdoj punën në shkollën e mesme t’muzikës.

Petrit Çeku: A ju kujtohen pedagogët në Beograd?

Sevime Gjinali: Pedagogët...

Petrit Çeku: Profesorët?

Sevime Gjinali:... ma t’njoftun edhe kompozitorët që janë, kam qenë... se çdo profesor ka pasë në klasë deri maksimum dhetë studentë. Në këto landët kryesore, harmoni e polifoni, e kam pasë profesor Stanojev Rajiqi, përndryshe kompozitor i njoftun, ni emën i njoftun, Petar Bingulci, Aleksander Obradovic, Stefan Vuk... ky, Mokranc i ri...

Petrit Çeku: Mokranjac?

Sevime Gjinali: Po. Kam qenë shumë e ledhatume nga ata dhe, bile profesori im i landës kryesore m'ka pasë thanë në gjuhën serbishte “Vazjë”, “*čerko*” thoshte, “Vazjë, une kam dëshirë që ti t'mbetesh këtu t'bohesh asistente imja”. Une nuk e disha vlerën e asistentes, atëhere s'kemi pasë asistent vetëm profesorat na jepshin muzikë. Une atë s'e mora shumë seriozisht. Përndryshe, në kohën e studimeve, masi isha aktiviste në ni shoqni t'studentëve aty, bashkë kemi qenë shqiptarë e serbë, e krejt... kroat ka pasë të Bosnjës... pata konkuru në Radio Beograd, ishte ni konkurs për redaktor t'muzikës serioze.

Une si e re, hajt t'shkoj t'konkuroj. Edhe u pranova aty. Këta shoktë m'thojshin, “A ke ndërmen me met?” “Jo bre,” thashë, “veç ajo me kqyr çka po bohet”. Domethonë, u pranova. Mirëpo, meniherë mas studimeve u ktheva në Prizen në shkollë e mesme të muzikës si arsimtare.

Petrit Çeku: A ju kujtohet jeta koncertale atje? Koncertet...?

Sevime Gjinali: Atje, atje në studime kemi pasë si obligim me i vizitu të gjitha ngjarjet muzikore që boheshin, koncertet e shumta që vishin edhe nga bota, edhe aty ngjarjet që boheshin në Kollarcev, Universiteti i Kolarcit ka qenë. Përndryshe, opera ka pasë ekzistu... kështu që, ne na jepshin tiketa, bileta pa pagesë edhe si të, obligim kemi pasë çdo ngjarje, çdo ndodhi, çdo shfaqje operistike, koncerte t'filharmonive, solistike, recitale, me, me i ashtu.... Përndryshe s'kemi pasë tjetër... kompjuteri s'ka ekzistu në atë kohë. Edhe ajo na ka mbajtë, edhe kemi pasë zhvillu shumë kulturën muzikore klasike e kemi njoftë me kompozitor, me ekzekutus, me artista të ndryshëm. Ka qenë ni, ni plus për, për ne, për studentë që t'njifemi me ato gjana, tash po... mungojnë për këtë kohë. Edhe kemi marrë ni dijeni, ni avasim për ne ka qenë.

Petrit Çeku: Kolegët në atë kohë...

Sevime Gjinali: Po...

Petrit Çeku: ... si, a keni ndonjë përshtypje që...

Sevime Gjinali: Përshtypja jonë ka qenë, ne kemi qenë ni rreth, masi kemi shku prej Prizrenit katër-pesë vet, edhe kemi dalë prej shkollës mesme si ni familje. Ajo, ai kolegialiteti dhe kujdesi ndaj femnës në atë kohë ka qenë shumë me randësi që mos me na lanë vetëm, mos me ndi vetën... se ajo ka qenë krejt ni botë tjetër për ne. Kolegët vazhdimisht kanë qenë si kujdestarë t'mi... bile ni, ni ashtu... prindtë e mi kanë pasë lanë amanet kolegëve ma t'vjetër që t'kujdesen për mu. Kam qenë edhe aty si e përkëdhelun edhe si pak ma e lazdrune se kam qëndru edhe me sukses mbi, mbi ta. Kur...

Petrit Çeku: Kur thatë, “Kjo ka qenë botë tjetër për ne...”

Sevime Gjinali: Po.

Petrit Çeku: A e keni vërejt ju në atë kohë që faktikisht jeni t’u e ndryshu shoqërinë?

Sevime Gjinali: Ne, ajo kohë ka qenë për ne se kemi me pasë ni përparim tepër t’madh edhe ne si, si studentë, si pasardhësit e kulturës tonë kemi me, me kontribu shumë për vendin tonë. Ajo ka qenë ni kënaqësi e madhe se kur t’kthehemi na kemi me ngritë krejt kulturën tonë, kemi me kontribu tepër që edhe Kosova të, të vijë në atë shkallën si ishte Beogradi, ose metropolet tjera.

Petrit Çeku: Shumë...

Sevime Gjinali: Kemi pasë mundësi edhe me shku në qytete si Zagreb, e... se kanë qenë ekzistiu, prej asaj kohë kanë pasë fillu festivalet. Mirëpo, nga mundësia e finansimit kemi qenë pak ma të rezervumë edhe me shkumjen e ktyne. Organizoheshin shetitjet kështu si... me tren udhëtimet kështu grupe në qytete me pa për shembull në Zagreb ni operë.

Petrit Çeku: A ju kujtohet, ajo, edukimi paraprak në Prizren që e keni pasë para se me shku në Beograd? Sa ka qenë substancial në raport me Beogradin?

Sevime Gjinali: Eh, ajo ka qenë shumë me randësi. Vlen t’theksohet na jemi dallu për nga suksezi nga të gjithë ata të kryeqytetit të Beogradit, kanë qenë... i kam pasë do kolege që vijshin me vetura në fakultet. Kanë qenë artistokrat, familje aristokrate atëherë edhe ata kanë qenë të rangume. Ne kemi qenë, unë s’kam pasë këpuca atëherë me veshë, me sandale shkojsha. Veshsha këpucat e shoqeve të mija (qeshë), kur shkojsha noj koncert. Ajo mos skamja menjherë mas luftës, edhe gjendja familjare na gjeti në atë pozitë. Suksezi, për nga suksezi jemi dallu, ni nivel ma të naltë kemi pasë se ata që kanë jetu në Beograd, ose të Novisadit, ose Nishit. Aty kanë qenë studentët, bashkë jemi ashtu... ne jemi dallu nga suksezi edhe nga talenti. Përndryshe, talenti është ai që është vendimtare për, edhe për sukses kështu.

Petrit Çeku: Po prej pedagogëve në Prizren kon e kishit theksu, prej atyne para...

Sevime Gjinali: Po prej pedagogëve si gjeneratë e parë unë e para u ktheva, se tash kolegët e mij metën edhe një vjet ma vonë. Disa fillunë me u punësu atje, disa nuk mujtën me kry menjëherë në afatin, e ne ishim tre vetë u kthyem prej Beogradit në shkollën e muzikës, edhe ata tre, unë, Engjëll Berisha edhe Mark Kaçinari në Prizren.

Mandej tri vjet punova në Prizren, me kërkesën e Radio Prishtinës se këtu ishte kryeqyteti... në atë kohë Radio Prishtina filloi me mledhë kuadro profesionale për disa redaksi, për gazetetari, për muzikë, edhe redaktori i Radio Prishtinës më ftoi që t'kaloj në Radio Prishtinë, t'punësohem aty në redaksinë e muzikës serioze.

Petrit Çeku: Veç edhe pak po më intereson Prizreni në atë ato tre vitet si ka...

Sevime Gjinali: Në ato tre vite unë isha shumë e ngarkume me mësimdhanien e shumë landëve se nuk kishte profesorë tjerë. Ishin disa në gjuhën serbo-kroate jepshin mësim. Ne ishim të parët që vynte me bo përkthime të landëve të muzikës. Historinë e muzikës, harmoninë në gjuhën shqipe, edhe aty kemi pasë një peshë me ju përgaditë ligjeratat fëmijeve, nxanësve në gjuhën amtare. Menihere une pesë landë i mora për me ligjeru, solfexhon si landë kryesore, piano, leximin e partiturave, kontrapunkt, përndryshe polifoni edhe folklorin muzikor shqiptar. Jo mosha ndërmjet nxanësve të mij edhe mosha ime, ishte aty përafërsisht një ose dy vjet ma t'ri se unë.

Petrit Çeku: A mundeni me i përmendë disa prej...

Sevime Gjinali: Ata ishin, përndryshe tash kompozitorë të njoftun, Zeqirja Ballata instrumentist, Isak Muçolli, Reshat Randobrava, Musa Piperku, e shumë të tjerë... Bahri Qela, Bahri Qela si dirigjent. Edhe une tepër e përgatitun shkojsha n'mësim. T'ju tregoj si një ngjarje që m'ndodhi, ky Shaqir Hoti ka qenë flautist... Hina ni ditë n'mësim, edhe kam qenë pak rigoroze, mirëpo kam ditë me ju përshtatë edhe humorit, edhe ata të dy ishin ulë aty afër njëri-tjetrit, Isak Muçolli me Shaqir Hotin, qeshën pak. Thashë, "Çka është puna për t'qeshë?" "Kuku, profesoreshë me ju tregu shka tha ky për ju". Thashë, "Shka tha?" "Kuku bre qet' profesoreshë me qitë n'fotografi, me ngjitë n'shishe me ujë, krejt i kishim shitë" (të gjithë qeshin).

Po më kanë nderu shumë se kam qenë unë me dijeni, kam rrezatu dijeni edhe ata më kanë dashtë tepër. Vazhdimisht ndigjojshin te dera une kur i bijsha pianos. Schopenin e kam pasë si kompozitor kështu që e kam ekzekutu shumë me andje. Edhe gjatë orës së mësimit kur u bonte, e shifsha që mo s'jonë të interesum, "Hajt profesoreshë ekzekutoni dishka". Ekzekutojsha.

Mbas shkollës së muzikës në radio, kontributi im në Radio Prishtinë ka qenë tepër i madh se redaksinë e muzikës serioze e kam avansu edhe kam shkru... i kam tregu për të gjitha kompozimet i kom bo analiza formale për me afriu ndigjusin edhe secilin kompozitor.

Petrit Çeku: Kjo është tepër e randsishme...

Sevime Gjinali: Po, se ka qenë në atë kohë, muzika serioze ka qenë ma pak e prezantume, megjithëqë në atë kohë edhe ka ekzistuar orkestri filharmonik t'u marrë edhe nga jashtë instrumentistë. E redaksinë

e muzikës serioze unë e rregullova aq bukur, komentet, t'u shkru komente t'u i zvoglu minutazhën e operave... se operat zgjasin një orë, ma tepër, unë me komente i shkurtojsha se minutazha ma e gjatë në Radio Prishtinë ka qenë 60 minuta, 60 minutshin kush e ndigjon? E komente të mija shkojshin me muzikë edhe për t'gjitha veprat. Kështu që, edhe mu m'konvenoj se kam pasë një dijeni kështu të madhe edhe aty përfitova tepër.

E drejtoria e Radio Prishtinës kur e pa që une redaksinë e muzikës serioze e rregullova bukur, hajde më transferun në muzikën popullore. Kështu që, edhe muzikën popullore për në atë kohë, veç une isha edhe si kompozitore, fillova me bo krijmtari për nevojat e Radio Prishtinës. Krijova mjaft kangë në frymën e muzikës popullore. Punova me një kor të fëmijëve edhe shkrujsha kangë për korin e fëmijëve.

Petrit Çeku: A ju kujtohet kur i shkrujshit tekstet, spjegimet, domethënë analizat për vepra të mdhaja çfarë audience e kishit parasysh?

Sevime Gjinali: E shifni aty ka qenë shumë me randësi se radiofonia i ka do ligje që për shembull, nëse shkon në mëngjes duhet me ju përshtatë kohës së mëngjesit, çfarë muzike me lshu? Në drekë tjetër, tjetër ashtu atmosferë, masdite tjetër edhe n'mramje. Kështu që, minutazha e muzikës klasike serioze ka qenë zakonisht n'mramje. Atëhere nuk ka pasë kontakt me ndigjuset, mirëpo kam pasë shumë vlerësime. Edhe kanë qenë, [kanë] ekzistuar garat e emisioneve të Radio Difuzionit, Jugosllavisë, garat se cili emision është ma i mirë edhe ne gjithmonë kemi fitu me emisione të Kosovës.

Mandej masi që u kry kjo puna ime në redaksinë e muzikës serioze unë kalova në muzikën popullore. Muzika popullore ishte jashtëzakonisht e pasur, mirëpo pak inçizime. Aty ishte bashkë edhe folklori muzikor shqiptar edhe fillim na me produktionin e muzikës në bazë të folklorit, komponimet. Edhe u hap edhe seksioni i produktionit muzikor. Aty u zgjanu rrethi. Erdhën kompozitorët Vincent Gjini, Lorenc Antoni, Rexho Mulliqi edhe fillim me kompozime, edhe të detyrume për muj me i bo dhetë kompozime. Vetëm ajo ka bo që të pasunohet fondi i muzikës, me dhetë kompozime.

Natyrisht që zgjidheshin ma të mirat, ato që ipeshin në emisione. Kemi pasë mandej lavdata, kanë bo hite jonë ndigju. Mandej festivali i Akordeve të Kosovës e ka mundësu edhe zgjanimin e fondeve kështu komponimin dhe pasunimin e fondeve të muzikës. Paraqitja e këngëtarëve, si me i zbulu kangëtarët popullor? Patëm organizu festival, Kosovarja Këndon. Për shembull, në Ferizaj mbaheste, edhe aty i zgjedhshim kangëtarët për inçizimet në radio. Krejt këto kanë qenë projektet si tash që egzistojnë projektet, ato projektet e mija kanë rrjedhë në atë kohë, u pasunu një, një fond tepër i madh.

Në kohën kur isha në radio unë paralelisht punojsha edhe në shkollën e mesme të muzikës si arsimtare e pianos. Kështu që, s'e kam ndërpre punën pedagogjike asniherë.

Petrit Çeku: A ju kujtohen Akordet e Kosovës, fillimi pak është mjaft interesant si ...

Sevime Gjinali: Akordet, po. Akordet një herë n'vjet kanë qenë, edhe në tri zhanre shkojshin. Kangët për fëmijë, kangët në frymën e muzikës popullore edhe zbavitëse, atëherë thojshin muzikë e lehtë. Ajo ka qenë festë për, për qytetin e Prishtinës.

Petrit Çeku: Ku u mbajshin?

Sevime Gjinali: Në Prishtinë, në Teatrin Kombëtar, se salla s'ka pasë atëherë ma t'përshtatshme. As sot e kësaj dite s'ka. Aty ka qenë muzika shqiptare, serbe, tyrke, varësisht prej komponimeve. Komisioni bante zgjedhjen se cilat kanë me shku edhe komisioni vendoste për, për shpërblimin e parë e kangën ma, ma t'bukur... tash si është kjo Zambaku i Prizrenit.

Erëmirë Krasniqi: A ka pasë cenzurë në këtë kohë?

Sevime Gjinali: Po, si jo? Po, si jo? Ajo cenzura mu m'ka kushtu shumë. Në atë kohë mardhaniet me Shqipërinë e dijmë se si kanë qenë. Kemi pasë edhe në fond kangtë e Shqipërisë, popullore zakonisht. Une si kompozitore ja kushtova Prishtinës kangën time të parë. Kanë qenë ditët e shlirimit për shembull, une për ditën e shlirimit i kushtova kangën e Prishtinës me tekstin tim, edhe ajo u pëlqy tepër. Në atë kohë ka pasë edhe njerëz shqiptarë që kanë punu për...

Erëmirë Krasniqi: Sistem?

Sevime Gjinali: Pengesa, me i bo pengesë shqiptarëve që mos të shkojnë përpara. Nji kolege erdhi te une në redaksi tha, "Ti e paske kopju kangën e Tiranës që këndohet në Shqipëri, ja ke bo Prishtinës". Se ata diletantë kanë qenë. Thashë, "Si po mendon kështu e kom kopju me tekst?" "Jo, po qashtu gati si ajo kanga e Tiranës". Thashë, "A i din notat?" "Jo, po e kam ndëgjju, e ke inçizu".

Kështu që, ajo pengesë u eliminu sepse dy kangë i lshum na. Ajo kurfarë lidhje, po asociacioni demek qysh e kam bo une atë, qysh ja kom kushtu, aty pari është ajo e ngjajshme. Edhe unë u bona si armik aty. Mirëpo, ajo u eliminu se e demantun edhe kolegët aty që s'është, s'ka kurgjo të bëj me asi.... Kanë qenë origjinale. Përndryshe, unë e kom pasë një stil, stil timin pak të ngjashëm si kangët e vjetra qytetare, natyrisht me elemente të muzikës tonë popullore.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë...

Sevime Gjinali: Gjithmonë kemi pasë pengesa, gjithmonë kemi pasë pengesa, po me ni dëshirë shumë të madhe, me ni përkushtim shumë të madh ja kemi arritë që të qëndrojmë në këto mendimet tona, dëshirat tona dhe ja kemi arritë. Mas punës time në Radio Prishtina dhe shkollë të mesme si me korrospodentë, u hap Shkolla e Lartë Pedagogjike me grupe edhe të muzikës. Aty prej vitit 1970 kalova

si e rregullt. U largova nga Radio Prishtina. Punova në seksionin e muzikës, ka qenë arti dramatik, piktura dhe muzika.

Erëmirë Krasniqi: Kjo është para se m'u themelu Univerziteti, a po? Veç Shkollë e Lartë?

Sevime Gjinali: Po, Shkolla e Lartë Pedagogjike ka qenë para fakulteteve në vitin 1974. Eh, në Shkollën e Lartë poashtu isha e ngarkume me shumë landë, landën e solfexhos, pianos, leximin e partiturave, se s'kishte kuadër. Në vitin...

Erëmirë Krasniqi: A ishte kjo kryesisht kulturë perëndimore, po mendoj e traditave perëndimore muzikës...

Sevime Gjinali: Po, patjetër. Shifni, muzika osht' e njejtë kudo. Ajo i ka bazat e veta. S'munet me qenë për shembull... asht' në baza nacionale, mirëpo muzika klasike osht' botnore. Edhe ato janë si ligje, për shembull çdo lande i ka pasë... si në drejtësi që i keni, drejtësia osht' e njejtë në ligje (qeshë), a osht' qashtu? Edhe muzika i ka pasë ato ligjet që janë shkru n'disa baza, që i kanë formu përpara shkenctarë e dijetarë.

Pjesa e Dytë

Petrit Çeku: Si ka qenë jeta koncertale në Prishtinë vitet e '70-ta, '80-ta?

Sevime Gjinali: Jeta koncertale po, ka qenë relativisht e vobekt se edhe salla nuk ka pasë përveç Teatrit Kombëtar edhe Filarmonisë që ka ekzistuar në kuadër të Radio Prishtinës, Akordet e Kosovës me muzikë klasike shumë pak, por me nxansa, me studentë, ajo ka qenë. Në Shkollën e Lartë Pedagogjike kemi pasë organizu profesorët bashkë me studentë koncerte. Edhe profesortë dilshin paraqiteshin edhe studentët ma të mirë në instrument. Mbas Shkollës Lartë në vitin 1974, '75, u avancu Shkolla e Lartë u bo Fakultet i Muzikës. Unë aty menjihërë automatikisht fillova t'punoj me kto landë edhe në dy grupe jipshim edhe ne gjuhën serbo-kroate edhe në gjuhën shqipe.

Bile është një ndodhi, erdhën disa mysafirë, filloj veç bashkëpunimin me Shqipërinë, erdhën disa.... N'atë kohë ka pasë shumë profesorë nga Shqipëria në Universitetin e Prishtinës. Erdhën si mysafirë me e pa se çfarë niveli kemi në Fakultetin e Arteve të Muzikës. Ishin dy femra, zakonisht nga dy-tri shkojshin, e thanë, "Sevime, a keni naj landë tash, a keni msim?" "Po," thashë, "une kam msim në paralelen serbe", se kam pasë dhanë msim edhe në paralelen shqiptare edhe serbe. "Por, si? Paralele serbe? Ju i jepni serbve msim?" "Po," thashë, "për mua është një plus që mundem me i dhonë edhe serbve msim, kemi arritë që edhe serbve t'i japim msim". Na kemi marrë msime në Beograd në

serbisht, po tash mund t'i japim edhe serbve. Edhe kemi pasë studentë prej krejt Jugosllavisë.

Kanë pasë ardhë edhe ata, jo për shkak të nivelit ma t'ult, kriterionit ma t'ult, po niveli barabart ka qenë. I tregova se studentët e mi kanë pasë shku në garat e landës time solfexho dhe vendet e para i kanë fitu, n'qendër të Beogradit, edhe në Zagreb.

E manej, ajo kohë ka qenë se, ka qenë pak direktiva edhe politike. Une si femën, hajde tash Sevimen ta çojmë në "Shotë". "Shota" ka qenë institucion profesional i kangve dhe valleve. "Po," thashë "une kam vendin këtu, une jam profesor edhe kanë nevojë... une du me dhanë kontributin tim në pedagogji". "Jo, se na kemi, për me ngritë atje duhet njerz profesionistë me i çu n'kto institucione". Une, "Jo, jo, jo jo". "Po, ke me shku", edhe direktiva partiake.... Atëhere patjetër vynte me hi n'parti për m'u bo ose drejtor ose profesor (kollitet), nejsë....

Edhe mu m'caktunë me detyrë në Ansamblin Folklorik "Shota", drejtoreshë. Edhe kte m'bindën kolegët e mi që kanë qenë nëpër kto partitë. Edhe Ansambli Folklorik "Shota" në... tash, une s'po del, po del se po livdohem... në atë kohë mori një hov t'madh artistik. Une menjherë u lidha, edhepse s'e kishim shumë t'lejume, me koreograftë nga Shqipëria. Panajot Kanaçi...

Erëmirë Krasniqi: Kanaçi...

Sevime Gjinali:... ishte i njoftun, një koreograf i Shqipërisë, edhe bonëm kontakt edhe arrita me e pru Panajot Kanaçin, me e vendosë "Vallen e Shqipeve". Vallja shumë simptomatike kshtu për Ansamblin. Valltartë kanë qenë t'shkëlqyshëm. Edhe vallja u vu edhe vetëm një paraqitje kemi pasë, edhe u ndalu. U ndalu se u çunë peshë, publiku kiametin e bonte me shku në koncertet e "Shotës", me e pa "Vallen Shqipe". Aty unë derisa isha... mu m'pushoi vendi i punës në Fakultetin e Arteve. Une nuk kisha dëshirë që t'jem drejtoresha aty vazhdimisht edhe kalova prapë në Fakultetin e Arteve.

Erëmirë Krasniqi: A pasoi naj ndëshkim për shkak t'ksaj paraqitjes së "Valles"?

Sevime Gjinali: Jo, jo, jo jo. Ndëshkimet s'kanë qenë, po cenzura ka qenë vazhdimisht për programet tona, se aty caktoheshin përqindjet: kaq shqip, kaq serbisht, kaq turqisht. Bile, e kemi pasë një paraqitje në Tiranë me ksi programi miks, domethanë edhe serbisht. Ata vazhdimisht thojshin, "Pse, pse turqishtën me e futë n'program?" "Po ne e kemi kët' sistem s'kemi shka t'bëjm". Megjithëqë, ajo muzika ishte muzikë. Kangtartë t'shkëlqyshëm kanë qenë, valltartë poashtu.

Ka qenë Jordan Nikoliqi, një këngtar tepër i mirë, një tepër interpretus i mirë, ai knonte shqip. Shumë kangtarë serbë knojshin shqip. Mandej, ma vonë fillunë atyne me iu bo vrejthe, "Pse ti me këndu shqip se ti je serb?" E u përzi ajo punë. Une u ktheva para se ta kryj mandatin, u ktheva në Fakultetin e Arteve. Në ndërkohë, Televizioni i Prishtinës kishte nevojë prapë për një organizator. M'thirrën që të

kaloj një kohë atje, po me një vjet, ma pak se dy vjet aty qëndrova. U ktheva përfundimisht në Fakultetin e Arteve si pedagogë, masi...

Venera Mehmetagaj - Kajtazi: Drejtor ke qenë edhe aty.

Sevime Gjinali: Masi aty, në këto vende tjera tregova sukses për punën time, une vazhdimisht kam qenë e përkushtime për, për punë. Unë e kom bo vetëm një vajzë, Venera. Ajo aty është flautiste e njoftun tash, për mos me lindë më fëmijë se une kom punë shumë. Ashtu ishte një, një... familjarisht e kemi pasë atë ndjenjë që më shërby dikujt, po për të mirën e vendit me siguri. U ktheva në Fakultetin e Arteve edhe aty tash hajde mu mësonë dekanë. Dekanë e parë shqiptare isha une.

Erëmirë Krasniqi: Qysh i organizutë departamentet aty?

Sevime Gjinali: Departa.... Po si dekanë, përndryshe të kthehem në Radiotelevizionin e Prishtinës. Aty arrita me e formu kori profesional, kori profesional me dirigjentin Rafet Rudi, përndryshe kompozitor. Ai kor edhe sot ekziston, kori në kuadër të Filarmonisë. Kemi shëtit nëpër krejt Evropën, si kor që ka marrë vlerësime shumë të larta për ekzekutim profesional. Qaty kom pasë edhe një kontribut. Në Fakultetin e Arteve i hapëm disa degë që s'kanë qenë ekzistuar. Kemi pasë marrë profesorë nga jashtë, seksionin e pianos, seksionin e flautit, të violinës kanë qenë disa profesorë me emra kështu të njoftun, sidomos pianistët.

Si dekanë, isha me mandat ma të shkurtër se erdhi koha fillunë ndryshimet, fillunë çrregullimet. Në vitin 1990 une i pata mbush 35 vjet shërbim, jo 30 vjet shërbim. Në atë kohë femna dilte në pension me 35 vjet po kishte edhe pensionim para kohe. Une me ikë ktyne ngjarjeve, se fillunë me u bo disa gjana të papëlqyeshme, u pensionova. Mas pensionimit, jo që po...

Erëmirë Krasniqi: Ju lutem, a të flasim ma shumë për njerz të cilët keni komponuar edhe qysh ka qenë qajo jeta si kompozitorë se po...

Sevime Gjinali: Kompozimet e mia kanë qenë barabartë me jetën time kështu aktive. Ajo ka qenë një, një ushqim për mua. Kam pasë fillu me këngë për fëmijë që i kam kushtuar fëmijëve dhe Venerën e kam pasë si...

Erëmirë Krasniqi: Model.

Sevime Gjinali: ...model, jo model po ajo i këndonte këngët e mia në Akordet e Kosovës. Ka qenë fletushka "Pionieri", ata për "Pionierin" vazhdimisht kam shkrujt, çdo javë e botojshin këngët e mia, kompozimet e mia. E mandej këngët në frymën e muzikës popullore i këndonte Nexhmije Pagarusha, e njoftun, duet me mua.

Mandej, fillunë kangtartë tjerë Shahindere Bërlajolli, Liliana Çavolli, Ismet Peja, e shumë, e shumë tash s'ka nevojë t'i numëroj. Kangtë e mia korale i kanë pasë ekzekutu koret e fëmijëve, muzikë, kangë për za e për piano ka pasë ekzekutu Nexhmija [Pagarusha], përcjellje, une e përcjellsha, Jordan Nikoliqi këndonte, tenori, shqip zakonisht, kështu me radhë. Kanë pasë disa miniatura pianistike që nëpër shkollat e muzikës tetë-vjeçare i kanë ekzekutu. Jom marrë me botimin e librave profesionale të solfexhit për shkollat tetë-vjeçare. E kam edhe librin për Fakultetin e Arteve të landës solfexhit.

Njikohësisht, gjatë veprimtarisë time, ma herët kur filloi të zhvillohet muzika kulturës, kemi pasë qenë ni grup, une, Anton Çetta dhe Engjëll Berisha, kemi shku n'teren për me mledhë folklorin burimor shqiptarë për me botu n'libra. Mandej edhe ato m'i deshifru. Kemi pasë inçizu në magnetofona, ato t'vjetrat. Kemi shku në disa rajone, n'katunde, se përpara ka qenë jo e zakonshme që femna t'i këndoj mashkullit. Une si femën shkojsha, ma lehtë e kisha nëpër odat e vajzave, m'i bo ato me këndu edhe mandej m'i deshifru. Ato janë botu në disa vëllime të profesor Anton Çettës në, nga Instituti Albanologjik në Librat e Folklorit Shqiptar.

Erëmirë Krasniqi: A keni naj tregim prej kësaj punës në teren? Naj anekdotë?

Sevime Gjinali: Po, shumë vështirë ka qenë. Ka qenë e vështirë se ka qenë ni kohë jo e mirë... vështirë vendosshin vajzat me këndu. Une ma shumë si mashkull kam qenë edhe shkojsha edhe inçizojsha edhe kangtë e burrave edhe këtyne femnave, edhe kështu që.... Anekdotë s'kom, po vazhdimisht Anton Çetta ka qenë ai që bonte këto afrime edhe bashkarisht i tregonte ngjarjet e që bazoheshin në folklor.

Erëmirë Krasniqi: A keni qenë edhe në Drenicë?

Sevime Gjinali: Drenica ka qenë, po Drenica. *Serbica*, tash Skenderaji a? Eh, qëkto rajone i kemi pasë. Aty ka qenë me t'vërtetë folklori shumë i pasun. Edhe janë botu ato të gjitha, janë inçizu, janë deshifru, po ka mbetë ende mandej. Ka vazhdu ni nxanës i im, Bahtir Sheholli, i ka vazhdu ato. Ai osht' ni folklorist që ka vazhdu ato traditën e mbledhjes së folklorit. Edhe Rexhep Mulliqi, folklorist, përndryshe edhe ai ka qenë nxanës i imi në shkollën e mesme. Une kom qenë ni motivuse për krijimtari.

Krejt këta nxansët që i kam pasë në shkollën e mesme t'muzikës, une i kom mësu ata si ta bojnë formën e ni kange. Me spjegime kështu muzikore, profesionale, edhe të gjithë kanë komponu... mandej jonë bo t'njoftun... Isak Muçolli, Reshat Randobrava me kangë kështu të lehta muzikore, Shaqir Hoti, Musa Piperku shumë i njoftun për kangët që ja ka knu Sabri Fejzullahu (qeshë).... Me

t'vërtetë kanë qenë kangë që kanë lanë mbresë edhe ekzistojnë sot e kësaj dite.

Petrit Çeku: Procesi i inçizimeve, a ju kujtohet kualiteti i pajisjeve në Radio Kosovë? Kështu veç shkurtimisht...

Sevime Gjinali: Po, ato stabilimentet zakonisht kanë qenë t'huazume në Radio Prishtinë, se në ni formë huazoheshin edhe ktheheshin aty ku janë marrë. Kemi pasë ni studio. Ajo studio ka shërby për t'gjitha, edhe për solistë, edhe për orkestër, edhe për krejt. Natyrisht që kualiteti nuk ka qenë i nivelit t'lartë, poashtu ka qenë kudo, n'çdo qendër, t'rajonit po mendoj. Manej, ma vonë fillunë të na vinë stabilimentet. Furnizoheshin, prej nga nuk e di, se ka qenë Radio Difuzioni që t'gjithë i bashkojshin ato kërkesat edhe na vishin nga jashtë. Ne kemi pasë mundësi me marrë, për shembull San Remoja Italisë, kangët e San Remos ma s'pari Radio Prishtina i ka pasë emitu.

Petrit Çeku: Interesant.

Sevime Gjinali: Po, se Skender Gjinali ka qenë redaktor i muzikës në atë kohë. Ai shkonte, se italishten e ka pasë njoft shumë mirë, drejt në San Remo i merrte inçizimet. Edhe prej nesh mandej i merrte Beogradi, Zagrebi, Shkupi, të gjitha këto radio stacionet tjera.

Erëmirë Krasniqi: A ju influencojshin kangtë e... po menoj ka i kishit influencat n'muzikë? Po menoj, e pasket shiku shumë San Remon, domethonë?

Sevime Gjinali: Po.

Erëmirë Krasniqi: Çka tjetër keni shiku edhe a ka pasë, a ka ndiku... a ka pasë ajo najfarë ndikimi kulturor?

Sevime Gjinali: Po sigurisht. Ajo ka qenë ni lloj që thojnë *yrneku*¹ për me pa se ku jeni e si duhet me vepru. Megjithate, muzika italiane gjithmonë e ka majtë atë primatin që ka qenë muzika ma e mirë edhe ma, ma e ndigjushme, ma... Po aty s'jemi larg se edhe muzika shqipe edhe italiane aty pari jonë pak ma, jo t'afërt, po i flen dëgjusit.

Petrit Çeku: Ni pyetje po du shumë mrapa me shku. A ju kujtohet konakti parë me muzikën klasike, n'përgjithësi, momenti parë? Përafërsisht, a ju kujtohet?

¹ Turq. *yrneku*, model.

Sevime Gjinali: Po, e kemi pasë, si çdo shtëpi si zakonisht ka pasë radion e vet, po ne në atë kohë s'kemi mrrri si fmijë me pasë qasje n'radio, se prindit, baba digjonte këto radio stacionet se ngjarjet që ndodhshin, ndodheshin, i ndigjoishin ata. Na s'ja kemi vu shumë veshin. Ma vonë, me fillimin e televizionit fillunë të gjitha zhvillimet edhe kontaktet tona n'atë kohë, e përndryshe s'kemi pasë mundësi tjera.

Petrit Çeku: Domethonë, me gjasë n'radio për herë t'parë e keni ndëgju Betovenin për shembull?

Sevime Gjinali: Po, po, si jo. Po, edhe, edhe këto radio stacionet e huja ma pak kanë dhanë asi muzike, ma pak, por...

Petrit Çeku: Po.

Sevime Gjinali: Nuk ka qenë ndigjushmëria aq e madhe sa.... Manej, me fillimin e shkollës muzikës si nrxanës manej na jemi aktivizu, vet i kemi kërku ato radio stacionet me gjetë, me pa se qysh po ekzekutohet ni pjesë e Schopenit, ose Brahmsit, ose Betovenit. Filloi ajo ta merr hovin e vet, se gjithçka me kohën e vet e boni t'vetën.

Petrit Çeku: Kthehemi në vitet e '80-ta kur u bëtë dekanë në Fakultet.

Sevime Gjinali: Po.

Petrit Çeku: Domethënë, si ka qenë atmosfera në ato vite, a ka pasë ndoni ndikim çështja e protestave t'studentave?

Sevime Gjinali: Po, po, si jo. Ka qenë presion i madh. Ne kemi pasë, dekanët, e kemi pasë vazhdimisht kontaktet me rektoratin për me tregu se sa studentë kemi me regjistru shqiptarë, sa serbë, sa të tjerë. Si dekanë une kom pasë probleme për me tregu numrin kaq përqind shqip, kaq përqind serbë. Edhe me ni rast une thashë s'di sa përqind shqiptar, xero përqind serbisht. Edhe manej patën kcy, "Qysh, shka do me thanë kjo, qysh muret me ekzistu xeroja?" "Po," i thashë, "ne kemi, na kemi nevojë për studentë".

"Po, mirë," thashë, "ça ka lidhje ajo?" Për mu s'ishte ajo ngarkesë, por, thashë, "Ju po e ngarkoni vetën tash inferior pse xero përqind. Sivjet muret me qenë xero përqind, po vjetin tjetër muret me pasë". E qe këtu kanë qenë ato mosmarrveshjet që kanë ndiku. Po...

Erëmirë Krasniqi: A dilshin studentat e juj në ato protestat e '81-shit? Po mendoj a ishin...

Sevime Gjinali: Të gjithë kanë dalë. Të gjithë kanë dalë. Protestat kanë qenë.... Se ai mllefi veç shpërtheu në atë kohë, megjithqë u heshtë në ni mënyrë, po... si prushi që rrin ashtu, digjet, ashtu mbeti.

Petrit Çeku: A vazhdut ju në ndërkohë me krijimtarinë?

Sevime Gjinali: Une ma pak atëhere, në atë kohë ma pak vazhdova. Nuk dojsa me shku në Radio me ju imponu me... se kisha këndej jo punë, e me...

Petrit Çeku: Po, janë ndryshu...

Sevime Gjinali: ...punë pedagogjike, punë si udhëheqëse. Vazhdimisht nëpër ato pleqësitë, e forumet, n'kuadër të Fakulteteve isha vazhdimisht aty e angazhume, kështu që s'kisha kohë as me bo fëmi (të gjithë qeshin).

Erëmirë Krasniqi: Në fillim të '90-tave jeni pensionu në fakt, a po? Kur filloj me u...

Sevime Gjinali: Po. Me '90-tën, me '91-shin e kam marrë pensionin e parë. Pensioni im... rrogën e kam pasë ni milion dinarë, pensioni më doli 990 dinarë.

Petrit Çeku: Me inflacion?

Erëmirë Krasniqi: Çka ishte ky kalim prej ni milionve?

Sevime Gjinali: Po ato ishin 400 marka, po. Veç n'atë kohë filloi ndrrimi i valutave, shkëmbimi për shembull. Edhe prej 400-ve rashë në 80 euro deri vjet, prej vjetshit 230 euro pensioni im. Eh, edhe ni sen harrova me ju tregu se mbas pensionimit tim, ngjarjet e dini, lufta, edhe dhetë vjet nuk ka pasë aktivitete. Ka pasë, këto tjerët organizojshin mësimë nëpër shtëpija, unë aty nuk u angazhova. Ma vonë, vitet 2000, 2001, më ftunë që të vazhdoj punën time pedagogjike me, në Fakultetin e Arteve, me landën time se atëhere u formu, u hapë edhe seksioni i masterit, i magistraturës. Dhe aty vazhdova edhe dhjetë vjet punova.

Erëmirë Krasniqi: Përnime?

Sevime Gjinali: Dhetë vjet deri sa e bona, se u mundsu me ligj të Universitetit se profesorët mundën me dhonë kontributin e tyne deri sa bojshin moshën 70 vjeçare. Edhe une deri moshën 70, 71 e kalova

pak, punova, edhe mandej ma u mbyllën. E ndisha vetën të aftë për me punu prapë, veç që s’kishte... Përndryshe, në Evropë, në muzikë edhe në artet tjera, deri sa asht’ njeriu i aftë mundet t’veprojë, t’punojë. Te ne atë me ligj e shkurtun. Tash nuk e di, m’duket që osht’ 70 vjeç i fundit, afati fundit që munden me vepru.

Petrit Çeku: Po m’duket kështu është.

Erëmirë Krasniqi: A mundesh me na tregu edhe për luftën, qysh e keni kalu?

Sevime Gjinali: Luftën, shumë keq. Lufta na erdhi... megjithqë kishim dëshirë dishka të ndodhi, të ngjajë, dishka që t’shlirohemi se familjarisht edhe pa luftë kemi luftu. Mendojshim se lufta shumë shpejt ka me u kry. Edhe ndodhi ajo që t’largohehi prej shpisë. Ikëm...

Erëmirë Krasniqi: Ku ishit ju, në Prizren apo?

Sevime Gjinali:... ne vendosëm që t’shkojmë në Turqi. Në Turqi, në ni shtëpi të vajzës, dhandrrit tim. Edhe të fundit vendosëm me dalë, në fund na vendosëm me veturë me dalë, gjithë veç kishin shku, na t’fundit. Te, te kufini i Maqedonisë na ndali policia. Une isha me bashkëshortin. Tha, “Ku po shkon? Ktheu mrapa!” Na e paskëm kalu atë stopin që paska qenë aty... as s’e kemi pa, si trullun ishim. Ai burri im u vonu se donte me regjistru sigurimin a ça di une... gjithë kanë ikë. Na kthej mrapa, tha, “Ke me nejt aty deri nesër”. Na si qyqana po rrim aty. Thashë, “Skender bre, a t’shkoj une te polici ta pys a mundemi me kalu, shka do t’bohët me ne?” “Hajt de, hajt shko”.

Shkova une, ju afrova. “Šta ćeš?” [Çka do?] Tha. Thashë, “Hajde bre pusti nas”, lirona edhe t’kalojmë na. “Po,” tha, “a s’e patë aty stopin?” Thashë, “Po burri s’e pa”. “E ti, pse s’po vozit ti?” “Po”, thashë, “une jom qorr, nuk shoh me vozit”. “Ajde shko”, tha. Shkum na (qeshë), shkum, e kalum. Diku rrugës u takum me vajzën, me familjen, me nipat, edhe mrrim në Turqi. Në Turqi na pritën shumë mirë. Fillunë me na dhanë ndihma. Burri im ka qenë vend... lindjen e ka pasë në Izmir.

Këta krejt kosovartë na u mbledhëm në ni vend aty ku ka qenë ni pushimore, verore... si qytezë verore thojshin ata. I thojshin, “Skender, çu bre Skender shko në radio, radio fol për veti se je i Izmirit. Pasha Zotën t’presin shumë mirë. Edhe pensionin munesh me nxjerrë” (qeshë). Përndryshe, vjerrri im, baba i burrit tim, ka qenë bashkëpunëtor me Fan Nolin. Fan Noli e ka prejardhjen nga ai vend ku e ka bash n’pushimore te Sharkyj [Šarköy], vendlindjen, Fan Noli.

Petrit Çeku: Sharkyj.

Sevime Gjinali: Edhe kur kanë ikë ata, se kanë jetu në Shqipëri, kanë qenë t'denumë prej Zogut edhe kanë ikë në Shqipëri. Fan Noli jau ka bo vendin që t'shkojnë në Turqi, babës Skenderit. Ai ka shetitë, edhe ai patriot, prej ni vendit në Çanakale... osht' e njoftun Çanakalja përndryshe... atje i ka lindë vajza, Myzaferi, përndryshe ni msuse e parë në Kosovë, e Skenderi në Izmir. Ai ka qenë ushtarak i Kemal Atatürkut në atë kohe kur osht' bo ai ndryshimi madh i demokracisë, aty ka qenë. Ka luftu aty edhe osht' plagosë. Mas asaj kohe ai kthehet prapë në Shqipëri. Në Shqipëri kanë pasë pasuni, po vendlindja ka qenë e babës burrit tim, vjehrrit, Prizreni.

Gjinoll, ata kanë qenë Gjinoll... mirëpo burri im është marrë me sport, ka qenë sportist i dalluar, ka lujtë për, për "Tiranën", ka lujtë edhe për "Shkodrën", [për] italianët ka lujtë... e ka ndrru atë e ka pasë, mbiemnin pak, Gjinali e ka bo, se Gjinoll do me thonë gjin [njerëz]. A ekziston edhe Gjinollt, ekzistojnë tash në Prizren, familja Gjinolli.

E jeta në... gjatë ikjes tonë në Turqi... gjashtë muj kemi jetu atje. Fillunë ndihmat me na dhanë, na kanë ndihmu tepër. Kemi pasë edhe kusheri që, t'afërt, s'na kanë lanë keq. Po menxi pritshim kthimin në Kosovë. Thanë, "Rrini këtu punësohuni". Edhe mu ma gjetën punën, edhe Venerës ja gjetën punën në formimin e Fakultetit në...

Venera Mehmetagaj Kajtazi: Konservatoriumit në Edrene.

Sevime Gjinali: Konservatoriumit në Edrene. Kjo ka pasë mundësi edhe në Francë kur ka qenë si specializante me mbetë aty. Bile m'patë thanë, "Shka t'boj, po m'nalin këtu?" Thashë, "Në qofse mendon me nejtë aty, kurrë mo s'ke me u kthy në Kosovë". "Jo, atëhere po kthehem". Edhe nisoj veprum. As une, as kjo s'nejtëm në Turqi. U kthym në Kosovë, mas çlirimit. Me kthimin në Kosovë besoj që s'kemi gabu. Tash osht' kjo çka osht'.

Erëmirë Krasniqi: Shumë faleminderit.

Sevime Gjinali: È finito? [it. mbaroi]?

Erëmirë Krasniqi: Finito [mbaroi].